



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 104, datë 25.03.2021**

**PËR**  
**KOMANDIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARES**  
**ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës datë 19.03.2021 të gjyqtares znj. {...}, protokolluar pranë Këshillit me aktin nr.1230, datë 19.03.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim të hetimit gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**